

Në bazë të nenit 141, të Ligjit për arsim të lartë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, numër 82/2018) dhe nenit 89, të Statutit të Universitetit të Evropës Juglindore, Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 04.10.2019, e miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E PROGRAMEVE PËR PËRSOSJE PROFESIONALE DHE MËSIM JOFORMAL**

### **Dispozita të përgjithshme**

#### **Neni 1**

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet dhe rregullat e organizimit të programeve të ndryshme për përsosje profesionale dhe mësim jo formal në Universitetin e Evropës Juglindore – Tetovë (në tekstin e mëtejshëm Universiteti), duke pasur parasysh konceptin e mësimin gjatë gjithë jetës.

#### **Neni 2**

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga të gjitha njësitë e Universitetit që kryejnë aktivitete të arsimit të lartë.

#### **Neni 3**

Organizimi i programeve për përsosje profesionale dhe të programeve të mësimin jo formal në Universitet është në përputhje me Ligjin për arsim të lartë dhe Statutin e Universitetit.

### **Regjistrimi**

#### **Neni 4**

- (1) Regjistrimi në këto programe bëhet në bazë të thirrjes publike, ose brenda kornizave të bashkëpunimit me institucione/organizata të ndryshme publike ose jo qeveritare, si dhe në bazë të bashkëpunimit me sektorin e biznesit.
- (2) Kandidati duhet ta ketë kompletuar procedurën për regjistrim në programin përkatës, që përfshin: aplikimin, dorëzimin e dokumenteve të nevojshme, në pajtim me kërkesën e programit dhe realizimin e pagesës së paraparë.

### **Statusi i pjesëmarrësit në program**

#### **Neni 5**

- (1) Statusi i pjesëmarrësit në program, fitohet pas regjistrimit në njërën nga programet për përsosje profesionale në Universitet.
- (2) Statusi i pjesëmarrësit dëshmohet me kartë identiteti (*ID Card*).

### **Realizimi i programit**

#### **Neni 6**

- (1) Programi për përsosje profesionale dhe programi për mësim jo formal përpilohet nga njësia e Universitetit që kryen aktivitete të arsimit të lartë dhe realizohet sipas programit mësimor të modulit/lëndës (*Syllabus*).
- (2) Kohëzgjatja e programit varet nga vëllimi i plan-programit të paraparë.
- (3) Programi mësimor i modulit/lëndës (*Syllabus*) aprovohet nga Këshilli mësimor – shkencor i fakultetit përkatës dhe përfshin: përshkrimin, objektivat dhe rezultatet nga

të mësuarit, format e mbajtjes së mësimdhënies, mësimdhënësi, metodat e vlerësimit të dijes dhe aspekte tjera.

- (4) Pas përfundimit të programit, pjesëmarrësi merr certifikatë ose vërtetim, të cilën e lëshon njësia e Universitetit, respektivisht Universiteti.

#### **Pagesat**

##### **Neni 7**

- (1) Pjesëmarrësi paguan kompensim në shumë të caktuar për programin përkatës.
- (2) Për çdo pjesëmarrës, Universiteti hap llogari në sistemin elektronik për mbajtjen e evidencës së detyrimeve dhe pagesave të realizuara.
- (3) Çështjet e pagesave administrohen nga Zyra e bursarit.

#### **Delegimi i autoritetit**

##### **Neni 8**

- (1) Senati mund t'ia delegojë vendimmarrjen Drejtorisë Rektoriale dhe t'i ndryshojë kërkesat e parapara në këtë rregullore, por vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe për çështje të veçanta.

#### **Dispozita përfundimtare**

##### **Neni 9**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 07.10.2019.